32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

### **Neni 33 Pranimi i përkohshëm**

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, **një certifikatë e pranimit të përkohshëm.**

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose



- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

#### **Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet**

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose  
b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranimit të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose  
b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

#### **Neni 35 Pranimi përfundimtar**

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

#### **Shkelja e kontratës dhe shkëputja**

##### **Neni 36 Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose  
b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëshmipërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigojë brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta lirojë vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 "**Force Madhore**" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcaktojnë Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcaktojnë Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatuar periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.



### **Neni 39      PAGESA PAS SHKËPUTJES SË KONTRATËS**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpiqet shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

### **Neni 40              Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

### **Neni 41              Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

## **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

### **Neni 42              Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### **Neni 43              Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a)        ose vendim nga gjyqi;
- b)        kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

### PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës       |           | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK   |
|---|-----------|---|
| Përshkrimi i nenit                        | Neni. Nr. |   |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha              | 2.1       | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.  |
|   | 2.2       | Gjuha e përdorur do të jetë <b>gjuha Shqipe</b> .   |
| Siguria e ekzekutimit                     | 10.1      | Shuma e sigurisë së ekzekutimit është <b>10% i vlerës totale te kontratës me vlefshmëri prej 150 ditësh</b> .   |
| Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit | 11.2      | Shuma minimale e sigurimit do të jetë: <ul style="list-style-type: none"> <li>(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 te KPK, kontraktuesi korigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit te kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë;</li> <li>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;</li> <li>(c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</li> <li>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:</li> </ul> |



|                           |      |   |
|---------------------------|------|---|
|                           |      | <p>(i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar</p> <p>(ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar</p> |
| Programi                  | 12.1 | Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda <b>5</b> ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.   |
|                           | 12.2 | Periudha për Programin e azhurnuar është <b>15 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.</b>   |
| Fillimi i punëve          | 17.1 | Data e fillimit do të jetë <i>e përcaktuar në Planin e menaxhimit</i>   |
|                           | 17.2 | Data e përfundimit të gjitha Punëve do të jetë <i>120</i> ditë.   |
| Dëmet e likuiduara        | 19.1 | Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <b>0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës</b> për ditë.<br><br>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është <b>10%</b> e Çmimit final të Kontratës.   |
| Regjistri i punës         | 20.1 | <b>Një regjistër i punës do të mbahet në vendpunishte nga ana e Kontraktuesit,</b>  |
| Inspektimi dhe testimi    | 22.1 | Menaxheri i Projektit caktohet me Vendim të kryetarit.  |
| Pagesa                    | 24.4 | Pagesa do të bëhet në dy situacione në bazë të një urdhër-blerje të pranuar nga menaxheri i projektit, pagesa e parë e situacionit do të bëhet pas kryerjes së 50% të punëve.   |
| Parapagimi                | 26.1 | Shuma e Parapagimit është: <b>nuk ka pagese paraprake</b>   |
| Mbajtja e Parasë          | 27.1 | Shuma e parave të mbajtura është: <b>10% i vlerës së kontratës.</b>   |
| Shkaqet për kompensim     | 30.1 | Data e posedimit të vend punimit do të jetë <i>[shëno numrin]</i> ditë pas nënshkrimit të kontratës.  |
| Përgjegjësia mbi Defektet | 34.5 | Periudha garantuese e defekteve është <b>365</b> ditë   |

|  |      |   |
|--|------|---|
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve               | 42.2 | Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë  |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore | 43.1 | <p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>Ose</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> |



**SHËNIM**

**Pjesa C:** - Formulari i Dorëzimit të Ofertës – ky formularë duhet të përdoret vetëm nëse tenderi dorëzohet në kopje fizike. Përndryshe, në qoftë se tenderi dorëzohet në mënyrë elektronike, formulari krijohet përmes sistemit.

**PJESA C: FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT**

**Pjesa I. Formulari i Tenderit**

**Për: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

(në vazhdim të tekstit “Autoriteti Kontraktues”)

Titulli i kontratës: **Renovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore**

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. I kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit me Numër të Prokurimit: **616 18 066 521**. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

**Renovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore**

3. Çmimi total i tenderit është:

Çmimi i tenderit në shifra: 51708,<sup>22</sup> [shëno çmimin e tenderit në shifra €]

Dhe në fjalë PESEDHËJETE ENJEMIDE E SHIFATËQIND E ZETE QURD [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

E NDJEZET E BY CENT

4. Ky tender është valid për një periudhë prej **60** nga data finale për dorëzim të tenderëve.


5. [Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës **10% i vlerës se kontratës**.

6. Operatori Ekonomik [albi company dhe nënkontraktuesit tonë] kanë këtë nacionalitet: [Kosovar]

7. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet], me të drejtën tonë të udhëhequr nga ne. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër

[Në rast të konsorciumit]

[Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës].



4

8. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndë fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontrata tjera të financuara nga BKK

9. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj nesh nëse e bën këtë.

**E DORËZUAR NGA**

| IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK |                         |
|-----------------------------------|-------------------------|
| EMRI I KOMPANISË                  | ALBI COMPANY SHPK       |
| ADRESA E PLOTE                    | SYLEJMAN VOKSHI RAHOVEC |
| PËRFAQËSUAR NGA:                  |                         |
| EMRI & MBIEMRI                    | QAZIM BYTYQI            |
| POZITA                            | DREJTOR                 |
| NËNSHKRIMI                        |                         |
| DATA                              | 03/07/2018              |
| VULA                              |                         |

[Në rast Grupi Operatorësh ekonomik:]

|             | Emri (emrat) | Vend-selia |
|-------------|--------------|------------|
| Partneri 1* |              |            |
| Etj ... *   | ✓            | ✓          |

\* shtoni/fshini rreshta plotësues për partnerët sipas nevojës. Vini re që nënkontraktuesi nuk konsiderohet si partner për qëllime të kësaj procedure të tenderit.

Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar për të nënshkruar këtë tender në emër të Konsorciumit: [shëno emrin dhe mbiemrin] qazim bytyqi

Nënshkrimi: [nënshkrimi i personit të autorizuar]

Vendi dhe data: [shëno vendin dhe datën] rahovec 03/07/2018

Vula e Udhëheqësit: \_\_\_\_\_





PROJECTING.CONSTRUCTION AND CONSULTING

Albi Company sh.p.k

E-mail: albi\_company@yahoo.com

Tel: 044/049 152 846

RAHOVEC

PARAMASA

h

Numri i Prokurimit: 616 18 066 521– Titulli Renovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore

## **Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE**

**Përshkrimi i çmimeve është ngarkuar në sistem në dokumentin me emrin – Paramasa. Paramasen duhet të shkarkoni nga Platforma Elektronike.**





## PARAMASA

Paramasa është e përbërë prej dy pjesëve: Paramasa A dhe Paramasa B dhe në fund është Rikapitullimi për Cmimin e përgjithshëm për të dy paramasat

### Paramasa A: Renovimi i objektit Sali Safqe

Punët e dymëve, dritareve, dyshemeve, tavaneve dhe sivatimit të fasadave

| Nr. Përshkrimi   | Njësia         | Sasia  | Çmimi njësi pa TVSH | TVSH për njësi | Çmimi për njësi me TVSH | Vlera totale |
|--|----------------|--|---------------------|----------------|-------------------------|--------------|
| <b>Punët e dyshemesë së kafit, tavaneve të përdhësës dhe konstruksioni meskatësh</b> |                |  |                     |                |                         |              |
| 1.1.0  | m <sup>2</sup> | 200 m <sup>2</sup> për 100 ditë  | 0.07                | 0.01 €         | 0.08 €                  | 1,652.00 €   |
| 1.1.1  |                | Vendosja e skeleve përreth ndërtesës dhe largimi i tyre pas përfundimit të punimeve. Skelet duhet të mbështjellen me rrjetë PVC ose me ndonjë material të ngjajshëm rrethues.  |                     |                |                         |              |
| 1.1.2  | paushall       | 1  | 170.00              | 30.60 €        | 200.60 €                | 200.60 €     |
| 1.1.3  | m <sup>2</sup> | 30.00  | 1.70                | 0.31 €         | 2.01 €                  | 60.18 €      |
|  |                | Largimi i dyshemesë së përdhësës në tërësi në pjesën e banurës, dhe gropimi i dheut deri në 30cm prej pikës më të ulët të dyshemesë. Gjithashtu të llogaritet edhe bartja e dheut dhe materialit inert deri në deponi. |                     |                |                         |              |
| 1.1.4  | m <sup>2</sup> | 30.00  | 1.70                | 0.31 €         | 2.01 €                  | 60.18 €      |
|  |                | Furnizimi dhe vendosjen e një shtresës prej gurëve të lumit (me fraksion 8-10cm) me trashësi 12cm.   |                     |                |                         |              |
| 1.1.5  | m <sup>2</sup> | 30.00  | 1.70                | 0.31 €         | 2.01 €                  | 60.18 €      |
|  |                | Furnizimi dhe vendosja e një shtresë me zhavor (me fraksion 2-3cm) me trashësi 10 cm.  |                     |                |                         |              |
| 1.1.6  | m <sup>2</sup> | 30.00  | 4.00                | 0.72 €         | 4.72 €                  | 141.60 €     |
|  |                | Furnizimi me gëlqere dhe tullë të bluar dhe vendosja e shtresës prej llaçit horasan me trashësi 8cm.   |                     |                |                         |              |
| 1.1.7  | m <sup>3</sup> | 0.55   | 1030.00             | 185.40 €       | 1,215.40 €              | 668.47 €     |
|  |                | Furnizimi me hatullat prej druri bungi me dimensione 8x8 cm dhe vendosja e tyre në çdo 40 cm.  |                     |                |                         |              |



80



|        |  |                |       |        |          |            |          |
|--------|--|----------------|-------|--------|----------|------------|----------|
| 1.1.8  | Furnizimi me hi druri dhe byk dhe mbushja e hapsirave në mes të hatullave me hi dhe byk.   | m <sup>2</sup> | 30.00 | 1.20   | 0.22 €   | 1.42 €     | 42.48 €  |
| 1.1.9  | Furnizimi dhe vendosja e dyshemesë me dërrasa të struguara prej drurit të bungut me trashësi prej 2.2cm.   | m <sup>3</sup> | 0.70  | 850.00 | 153.00 € | 1,003.00 € | 702.10 € |
| 1.1.10 | Demolimi i pllakave nga murete kuzhinës dhe bartja e tyre deri në deponi.  | m <sup>2</sup> | 10.00 | 1.30   | 0.23 €   | 1.53 €     | 15.34 €  |
| 1.1.11 | Demolimi i elementeve sanitare nga banjo, pllakave të qeramikës dhe bartja e tyre deri në deponi.  | m <sup>2</sup> | 18.00 | 1.30   | 0.23 €   | 1.53 €     | 27.61 €  |
| 1.1.12 | Furnizimi me material nivelizues dhe nivelizimi i dyshemesë dhe mureve për vendosjen e pllakave në kuzhinë.  | m <sup>2</sup> | 10.00 | 3.85   | 0.69 €   | 4.54 €     | 45.43 €  |
| 1.1.13 | Furnizimi dhe vendosja e pllakave të qeramikës, ngjitësit, fugave dhe elementeve tjera përcjellëse për vendosjen e pllakave në dyshemenë e kuzhinës.   | m <sup>2</sup> | 4.00  | 13.50  | 2.43 €   | 15.93 €    | 63.72 €  |
| 1.1.14 | Furnizimi dhe vendosja e pllakave të qeramikës, ngjitësit, fugave dhe elementeve tjera përcjellëse për vendosjen e pllakave në muret e kuzhinës.       | m <sup>2</sup> | 6.00  | 13.50  | 2.43 €   | 15.93 €    | 95.58 €  |
| 1.1.15 | Furnizimi me material nivelizues dhe nivelizimi i dyshemesë dhe mureve për vendosjen e pllakave në banjo.  | m <sup>2</sup> | 18.00 | 3.85   | 0.69 €   | 4.54 €     | 81.77 €  |
| 1.1.16 | Furnizimi dhe vendosja e pllakave të qeramikës, ngjitësit, fugave dhe elementeve tjera përcjellëse për vendosjen e pllakave në dyshemenë e banjoes.    | m <sup>2</sup> | 3.36  | 13.50  | 2.43 €   | 15.93 €    | 53.52 €  |
| 1.1.17 | Furnizimi dhe vendosja e pllakave të qeramikës, ngjitësit, fugave dhe elementeve tjera përcjellëse për vendosjen e pllakave në muret e banjoes.        | m <sup>2</sup> | 15.00 | 13.50  | 2.43 €   | 15.93 €    | 238.95 € |
| 1.1.18 | Të bëhet gërmimi i dheut në pjesen e ahurit në thellësi prej 20 cm nga pika më e ulët e ti dhe bartje e ti deri në deponi.                             | m <sup>2</sup> | 15.60 | 2.50   | 0.45 €   | 2.95 €     | 46.02 €  |
| 1.1.19 | Furnizimi dhe vendosja e zhavorit ø 0-60mm me trashësi 10cm. Zhavori të ngjeshet mirë.   | m <sup>2</sup> | 15.60 | 2.50   | 0.45 €   | 2.95 €     | 46.02 €  |
| 1.1.20 | Furnizimi me gëlqere dhe tullë të bluar dhe vendosja e një shtrese prejllaçit horasan me trashësi 8cm.   | m <sup>2</sup> | 15.60 | 6.00   | 1.08 €   | 7.08 €     | 110.45 € |
| 1.1.21 | Furnizimi me gurë lumi rasuk ø 10 dhe vendosja e tyre në dyshemenë prejllaçit horasan. Vendosja e gurëve duhet të bëhet sa ështëllaçi horasan i njomë. | m <sup>2</sup> | 15.60 | 6.00   | 1.08 €   | 7.08 €     | 110.45 € |

7





|        |  |                |       |         |          |            |            |
|--------|--|----------------|-------|---------|----------|------------|------------|
| 1.1.22 | Furnizimi me vaj liri dhe lyerja e dërrasave të dyshemesë me të në dy shtresa.   | I              | 30.00 | 2.50    | 0.45 €   | 2.95 €     | 88.50 €    |
| 1.20   | <b>konstruksioni meskatësh</b>   |                |       |         |          |            |            |
| 1.2.1  | Zhvendosja e mobileve dhe inventarit të hapsirave të katit deri në obor, dhe mbulimi i tyre me ceradë që l reziston ujit.  | paushall       | 1     | 170.00  | 30.60 €  | 200.60 €   | 200.60 €   |
| 1.2.2  | Demolimi i dyshemesë nga dërrasat nga kati dhe bartja e tyre deri në deponi.   | m <sup>2</sup> | 50    | 1.30    | 0.23 €   | 1.53 €     | 76.70 €    |
| 1.2.3  | Demolimi i tavaneve të përdheshës nga pllakat gipsite dhe bartja e tyre deri në deponi.  | m <sup>2</sup> | 50    | 1.30    | 0.23 €   | 1.53 €     | 76.70 €    |
| 1.2.4  | Furnizimi me traje druri pishe dhe shtylla metalike me elementet përcjellëse për përforcimin e konstruksionit të meskatit gjat ndërrimit të trajeve të dëmtuara.   | m <sup>2</sup> | 50    | 5.00    | 0.90 €   | 5.90 €     | 295.00 €   |
| 1.2.5  | Furnizimi me traje druri bungi me dimensione 8x10, 10x12, 12x14 dhe 14x16 me gjatësi 4m deri në 6m, gozhdë dhe zëvendësimi i trajeve të dëmtuara me to. Vërejtje: dimensionet e sakta të trajeve miren pas hapjës së dyshemesë të katit. | m <sup>3</sup> | 1.5   | 1030.00 | 185.40 € | 1,215.40 € | 1,823.10 € |
| 1.2.6  | Furnizimi me dërrasa bungi 2.2cm, gozhdë dhe dërrasimi i tyre në dyshemenë e katit. Sipas nevojës për nivelizim të dyshemesë të vendosen edhe listella shtesë për vendosjen e dyshemesë.   | m <sup>3</sup> | 1.3   | 850.00  | 153.00 € | 1,003.00 € | 1,303.90 € |
| 1.2.7  | Furnizimi me pllaka gipsi dhe elemente përcjellëse për vendosjen e tyre në tavanet e përdheshës.   | m <sup>2</sup> | 50    | 5.00    | 0.90 €   | 5.90 €     | 295.00 €   |
| 1.2.8  | Furnizimi me material nivelizues për pllakat e gipsit në tavanet e përdheshës dhe nivelizimi i tavaneve në përdheshë.  | m <sup>2</sup> | 50    | 5.00    | 0.90 €   | 5.90 €     | 295.00 €   |
| 1.2.9  | Furnizimi me polikollor të bardhë dhe lyerja e tavaneve në përdheshë me dy shtresa.  | m <sup>2</sup> | 50    | 1.50    | 0.27 €   | 1.77 €     | 88.50 €    |
| 1.3.   | <b>Punët e trajeve të tavanit të katit dhe tavani i katit</b>  |                |       |         |          |            |            |
| 1.3.1  | Demolimi i iver pllakave nga tavaneve të katit dhe bartja e tyre deri në deponi.   | m <sup>2</sup> | 50.00 | 1.50    | 0.27 €   | 1.77 €     | 88.50 €    |
| 1.3.2  | Furnizimi me traje druri pishe dhe shtylla metalike me elementet përcjellëse për përforcimin e konstruksionit të katit gjat ndërrimit të trajeve të dëmtuara.  | m <sup>2</sup> | 50.00 | 5.00    | 0.90 €   | 5.90 €     | 295.00 €   |





|       |   |                |       |         |          |            |            |
|-------|---|----------------|-------|---------|----------|------------|------------|
| 1.3.3 | Furnizimi me traje druri bingu me dimensione 8x10, 10x12, 12x14 dhe 14x16 me gjatesi 4m deri ne 6m,gozhda dhe zëvendësimi i trajeve të dëmtuara me to. Vërejtje: dimensionet e sakta të trajeve miren pas hapjes së tavanit të katit. | m <sup>3</sup> | 0.80  | 1030.00 | 185.40 € | 1,215.40 € | 972.32 €   |
| 1.3.4 | Furnizimi me dërrasa pisehe 1.8cm, gozhda dhe drasimi i tyre në tavanin e katit. Sipas nevojës për nivelizim të tavanit të vendosen edhe listella shtesë.   | m <sup>2</sup> | 50.00 | 8.50    | 1.53 €   | 10.03 €    | 501.50 €   |
| 1.3.5 | Furnizimi me vaj liri dhe lyerja e dërrasave të tavanit me të në dy shtresa.  | l              | 15.00 | 2.50    | 0.45 €   | 2.95 €     | 44.25 €    |
| 1.40  | <b>Punët në muret e brendshme në ndërtesë</b>   |                |       |         |          |            |            |
| 1.4.1 | Zhveshja e mureve të brendshme nga suvaja dhe bartja e materialit inert deri në deponi. Vërejtje: pjesët e suvasë të cilat duhen ruajtur të përcaktohen nga organi mbikqyrës.   | m <sup>2</sup> | 260   | 1.50    | 0.27 €   | 1.77 €     | 460.20 €   |
| 1.4.2 | Furnizimi me tulla balte qerpiç, baltë dhe riparimi i mureve me to.   | paushall       | 1     | 200.00  | 36.00 €  | 236.00 €   | 236.00 €   |
| 1.4.3 | Furnizimi me gëlqere të shuar dhe rërë dhe suvatimi i mureve të brendshme me llaq gëlqerorë në trashësi 1.5cm-2.5cm. Vërejtje: gëlqerja të jetë e stagjonuar.   | m <sup>2</sup> | 260   | 5.00    | 0.90 €   | 5.90 €     | 1,534.00 € |
| 1.4.4 | Furnizimi me gëlqere të shuar dhe lyerja e mureve të brendshme me gëlqere në 2 shtresa.   | m <sup>2</sup> | 260   | 1.50    | 0.27 €   | 1.77 €     | 460.20 €   |
| 1.50  | <b>Punët e dritareve</b>  |                |       |         |          |            |            |
| 1.5.1 | Demontimi i dritareve ekzistuese me shumë kujdes.   | copë           | 12.00 | 10.00   | 1.80 €   | 11.80 €    | 141.60 €   |
| 1.5.2 | Punimi dhe vendosja e dritareve. Dritaret duhet të jenë të punuara nga druri I bungut me kualitet të lartë dhe identike me dritaret origjinale. Dritaret me dim: 135 cm x 90 cm.  | copë           | 1.00  | 270.00  | 48.60 €  | 318.60 €   | 318.60 €   |
| 1.5.3 | Punimi dhe vendosja e dritareve. Dritaret duhet të jenë të punuara nga druri I bungut me kualitet të lartë dhe identike me dritaret origjinale. Dritaret me dim: 130cmx180cm.   | copë           | 1.00  | 350.00  | 63.00 €  | 413.00 €   | 413.00 €   |
| 1.5.4 | Punimi dhe vendosja e dritareve. Dritaret duhet të jenë të punuara nga druri I bungut me kualitet të lartë dhe identike me dritaret origjinale. Dritaret me dim: 180cmx200cm.   | copë           | 4.00  | 550.00  | 99.00 €  | 649.00 €   | 2,596.00 € |
| 1.5.5 | Punimi dhe vendosja e dritareve. Dritaret duhet të jenë të punuara nga druri I bungut me kualitet të lartë dhe identike me dritaret origjinale. Dritaret me dim: 120cmx125cm.   | copë           | 1.00  | 300.00  | 54.00 €  | 354.00 €   | 354.00 €   |



*[Handwritten signature]*

*[Handwritten mark]*



|        |   |          |       |        |         |          |          |
|--------|---|----------|-------|--------|---------|----------|----------|
| 1.5.6  | Punimi dhe vendosja e dritareve. Dritaret duhet të jenë të punuara nga druri I bungut me kualitet të lartë dhe identike me dritaret origjinale. Dritaret me dim: 90cmx115cm.  | copë     | 1.00  | 250.00 | 45.00 € | 295.00 € | 295.00 € |
